

# MREKULLIA E MUZIKËS 2

KULTURA MUZIKORE  
për klasën e dytë të shkollës fillore  
LIBRI I MËSUESIT



**МУЗИЧКА КУЛТУРА**  
**за други разред основне школе**  
**ПРИРУЧНИК ЗА НАСТАВНИКЕ**  
**KULTURA MUZIKORE**  
**për klasën e dytë të shkollës fillore**  
**LIBRI I MËSUESIT**


Mr. Jelena Martinoviq-Bogojeviq  
Milena Papiq  
Bilana Durkoviq

Botuesi:	Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë
Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse	Nagja Durkoviq
Redaktore	Bilana Miranoviq
Redaktor i botimit në gjuhën shqipe	Dimitrov Popoviq
Recensentë	mr. Dobrilla Popoviq Ana Perunoviq-Razhnatoviq Snezhana Gjurihiq Branka Martinoviq Liljana Axhiq
Përkthyes	Zarija Brajoviq
Konsulent	Luigj Dedvukaj, profesor i lëndës
Ilustrues	Zdravko Beli Delibashiq
Partitura	Petar Gariq
Disenjoja dhe modelimi grafik	Jelena Sekuliq
Redaktor teknik	Rajko Radulloviq
Për botuesin	Nebojsa Dragoviq
Shtypur në	.....
Tirazhi	.....

CIP – katalogizacija u publikaciji  
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

# PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
KarakteristikatepërgjithshmetëlëndësmësimoreKulturamuzikoretëklasëssëdytëtëshkollësfillore.....	5
Të kënduarit, ecuria metodike e mësimi të këngës me anë të veshit muzikor.....	5
Këngët e numërimit.....	6
Dëgjimiimuzikës.....	6
Krijimtaria.....	6
Mësimi i Kulturës muzikore dhe arsimimi inkluziv.....	6
Kompleti muzikor“Mrekullia e muzikës 2”.....	8
<b>VJESHTA KËNGËTARE.....</b>	<b>9</b>
Mirë se erdhët.....	10
Çadra.....	11
Vjeshta.....	11
Në oborrin e shkollës.....	12
Oj goce, oj goce.....	13
Aj, baj.....	14
Ec, rosak i vogël.....	15
Vallja e Eros.....	16
Roza thurte flokt’e artë.....	17
Ja, kështu... ..	18
Kap ritmin.....	19
<b>DIMRI MAGJIK .....</b>	<b>20</b>
Dimri.....	21
Të njohim instrumentet.....	22
Ëndrra.....	23
Gëzim bore .....	24
Shkolla e muzikës .....	25
Pinoku .....	26
Mbrëmje magjike .....	27
Koncerti i Vitit të Ri.....	28
Gjendje të ndryshme shpirtërore.....	29
Çfarë kemi mësuar.....	30
<b>PRANVERA E HARESHME.....</b>	<b>31</b>
Lulebora .....	32
Uji rridhte valë-valë .....	33
Nëna .....	34
Dallëndyshja .....	35
Tri livadhe .....	37
Krijimtaria popullore .....	38
Enci menci .....	39
Curulaja .....	40
Ne vëllezërit terzie .....	41
Gjithë kjo është muzikë .....	42
Miqësia .....	43
<b>VERA E GËZUESHME.....</b>	<b>45</b>
Ruaje planetin .....	46
Përhëndetje nga Mali i Zi .....	47
Përgatitim shfaqjen .....	48
<b>Literatura .....</b>	<b>49</b>
Shënime.....	50



## *Hyrje*

Të nderuar mësues e mësuese,

Kompleti i tekstit mësimor “Mrekullia e muzikës 2” që keni para, është vazhdim i kompletit të tekstit mësimor “Mrekullia e muzikës 1”. Kemi synuar që përmes materialit të ofruar mësimor, ta ruajmë metodën krijuese dhe t’i zgjerojmë elementet e kulturës muzikore të parashikuara me Programin mësimor. Kriteri kryesor me të cilin jemi udhëhequr, ka qenë që materiali të jetë i kapshëm para së gjithash nga nxënësit, por edhe për ju që do ta shpjegoni, ta prezantoni e bëni më të afërt këtë material. Kultura muzikore është lëndë mësimi që, për nga përmbajtja e vet, është e hapur për frymën krijuese dhe për të mësuarit përmes lojës, kështu që shumë kërkesa për mësimin krijues dhe për pjesëmarrjen aktive të nxënësve imponohen vetvetiu. Shpresojmë se nxënësit përmes: këngës, lojës, fjalëshpejtave, zbulimit e njohjes së tingujve e të instrumenteve, si edhe të dëgjimit aktiv do ta zbulojnë vetë mrekullinë e muzikës. Libri i mësuesit përmban paraqitjen e metodave të caktuara të mësimin (mësimin e këngës me anë të veshit muzikor, mësimin e këngëve të numërimit, interpretimit me instrumentet e Orfit), si edhe përgatitjet e hollësishme të temave të mësimin. Me propozimet për ecurinë e orës së mësimin janë ofruar variantet që do t’u ndihmojnë mësuesve për ta zhvilluar me sa më shumë sukses mësimin e Kulturës muzikore.

Dëshirojmë që, përmes kompletit të tekstit mësimor, orët e mësimin të Kulturës muzikore të nxitin fantazinë e fëmijëve dhe të zhvillojnë aftësitë muzikore të nxënësve, ndërsa punën tuaj në klasë ta pasurojnë me përmbajtje të reja.

Autorke



## ***Karakteristikat e përgjithshme të lëndës mësimore Kultura muzikore të klasës së dytë të shkollës fillore***

Kultura muzikore në klasën e dytë përmban disa elemente bazë: këndimin dhe zhvillimin e veshit melodik, shqiptimin ritmik të teksteve dhe zhvillimin e veshit ritmik, interpretimin me instrumentet e Orfit e me burimet e tjera të muzikës, dëgjimin e pjesëve e të fragmenteve të shkurtra nga veprat artistike muzikore dhe kërcimin e lojërave muzikore. Përmes elementeve të përmendura zhvillohet edhe dëgjimi me përjetim i muzikës si kategori e zhvillimit emocional përmes dallimit e shprehjes së gjendjeve të ndryshme shpirtërore të nxitura nga muzika. Me lëvizjet që bëjnë nxënësit duke e shoqëruar muzikën, ata zhvillojnë motorikën, ndërsa me këngët e numërimit, nxitin shqiptimin si duhet të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, gjë që u ndihmon edhe nxënësve me vështirësi në artikullimin e rregullt të tingujve. Në mësimin e Kulturës muzikore është e pranishme edhe puna krijuese në grupe, përmes së cilës nxënësit mësojnë tolerancën, socializimin, empatinë e kolegjalitetin.


Me Programin mësimor është parashikuar që nxënësit në klasën e dytë të këndojnë këngët e thjeshta me anë të veshit muzikor, të shqiptojnë këngë numërimi me strukturë të thjeshtë ritmike, të zgjerojnë njohjen e instrumenteve klasike (flauti, fizarmonika, kitarë) e të instrumenteve popullore (fyejt). Zhvillimi i konceptimit për muzikën nxitet me njohjen e ngjyrave tingëluese të instrumenteve, të nuancave dinamike bazë, të llojeve bazë të tempos dhe të karakterit të muzikës. Qëllimet e përmendura kanë qenë të pranishme në Programin e klasës së parë, në ç'rast kërkesat dhe vëllimi i janë përshtatur fëmijëve të kësaj moshe. Në klasën e dytë zhvillohen në mënyrë analoge aftësitë psiko-fizike, por edhe ato muzikore të nxënësve, ndërsa kërkesat zgjerohen.

Në Librin e mësuesit janë dhënë shpjegimet e përgjithshme të ecurive metodike që do të zbatohen në mësimin e Kulturës muzikore, në mënyrë që të përvetësoni me sukses qëllimet e caktuara me Programin mësimor.

### ***Të kënduarit, ecuria metodike e mësimin të këngës me anë të veshit muzikor***

Veprimtaria kryesore në mësimin e Kulturës muzikore është të kënduarit. Nxënësit e kësaj moshe nuk këndojnë me nota muzikore, prandaj ecuria metodike e mësimin të këngës me anë të veshit muzikor është e domosdoshme të zbatohet gjatë mësimin të të gjitha këngëve të parashikuara për interpretim. Metoda e mësimin të këngës me anë të veshit muzikor është e ndarë në disa pjesë didaktike:

1. Në pjesën hyrëse të orës së mësimin krijohet atmosfera që i përgjigjet përmbajtjes së këngës dhe karakterit të saj.
2. Nxënësit mund të ushtrohen në të kënduar me interpretimin e ndonjë kënge tashmë të mësuar.
3. Në Librin e mësuesit është dhënë partitura e të gjitha këngëve të parashikuara për t'u kënduar. Mësuesi/mësuesja duhet ta këndojë këngën në mënyrë shprehëse, ndërsa, para se të fillojë ta zhvillojë me fraza me nxënësit, duhet ta analizojë tekstin e këngës. Theksojmë se incizimi i këngës (në CD-në shoqëruese) nuk duhet ta zëvendësojë kursesi "tingullin e gjallë". Mësuesi/mësuesja që nuk e ka intonacionin e qëndrueshëm, mund ta ndihmojë veten duke e shoqëruar të kënduarit me ndonjë instrument (piano, fizarmonikë, kitarë ose sintisajzer që përdoret me shpesh në praktikë).
4. Pasi që nxënësve u këndohet kënga në mënyrë shprehëse, mësuesi/mësuesja nis punën për përvetësimin e këngës me anë të veshit muzikor. Nxënësit dëgjojnë, mbajnë mend dhe i përsëritin pjesët e shkurtra të këngës pas mësuesit/mësueses. Ecuria përsëritet deri sa nxënësit ta mësojnë tekstin dhe melodinë.
5. Nxënësit duhet ta këndojnë këngën nga fillimi deri në fund. Mësuesi/mësuesja u jep atyre me instrument intonacionin fillestar.
6. Vetëm pasi kënga të jetë interpretuar në mënyrë e përshkruar më sipër, mësuesi/mësuesja mund ta lëshojë versionin e incizuar instrumental, me shoqërimin e të cilit nxënësit mund të këndojnë.



Ajo për të cilën do të tërhiqim vëmendjen, është dukuria e shpeshtë që nxënësit e kësaj moshe dinë të këndojnë në mënyrë të pakontrolluar me zë, gjë që krijon shprehitë e këqija të të kënduarit. Ja disa udhëzime që jep metodisti Jozhe Pozhgal:

1. Nxënësi/nxënësja duhet ta mbajë trupin siç duhet. Shpina mbahet drejt, trupi lirshëm, ndërsa koka dhe qafa mbahen gjithashtu drejt. Nxënësit mund të qëndrojnë në këmbë, por edhe ulur gjatë këndimit.
2. Gjatë këndimit, vëmendja duhet drejtuar tek frymëmarrja. Nxënësit duhet të marrin frymë në fund të njëres dhe në fund të frazës tjetër, e jo në çfarëdo vendi.
3. Në këtë moshë zhvillohet zëri i fëmijës. Për këtë arsye, duhet treguar kujdes që nxënësit të fitojnë shprehje për ta kontrolluar mënyrën e vet të të kënduarit dhe të mësohen të këndojnë me zë të ulët përmes shembujve të këngëve të mësuara.<sup>1</sup>

### ***Këngët e numërimit***

Me shqiptimin siç duhet të këngëve të numërimit me vlerat e shënuara të notave, nxënësit zhvillojnë kuptimin e ritmit. Këngët e numërimit interpretohen më shpesh duke i shqiptuar rrokjet në të njëjtën lartësi tingulli. Në Programin mësimor është parashikuar që këngët e numërimit në klasën e dytë mund të interpretohen në dy tinguj, gjë që do të afrohet në Librin e mësuesit si variant i mundshëm. Ritmi duhet të shoqërohet me instrumentet e Orfit (trokitësit, shkopinjët, triangli, tamburi), me përdorimin e mjeteve trupore si prodhues të tingullit (rrahja e shuplakave, kërcitja me gishtërinj) ose me instrumentet që i kanë punuar vetë nxënësit. Modelimi i shoqërimit muzikor është dhënë në orkestrimin e paraqitur në Librin e mësuesit. Këngët e numërimit dhe fjalëshpejtat mund të interpretohen me tempo të ndryshme (ngadalë, shpejt).

### ***Dëgjimi i muzikës***

Dëgjimi i muzikës duhet të jetë pjesë përbërëse e orës së mësimin. Temat e ofruara përfshijnë: këngët artistike për fëmijë, këngët popullore dhe fragmentet nga veprat klasike muzikore. Nxënësit e përjetojnë në mënyra të ndryshme atë që dëgjojnë. Atë që përjetojnë duhet edhe ta shprehin pas dëgjimit në varësi të veprimtarive që propozohen (vizatimi, të shprehurit me gojë, njohja e karakterit) dhe të qëllimit të vënë. Jemi përpjekur që përmbajtja e ofruar të jetë e larmishme dhe në përshtatje me moshën e nxënësve.

### ***Krijimtaria***


Komponenti krijimtari në mësimin e Kulturës muzikore është pjesë e reagimit të nxënësve ndaj muzikës. Ajo nënkupton si përfytyrimin e shoqërimit ritmik, ashtu edhe përjetimin e muzikës përmes vizatimit ose përmes ndonjë tjetër shprehjeje. Frymën e krijimtarisë në orën e mësimin, mësuesi/mësuesja e nxit edhe me vetë atmosferën, në të cilën nxënësve u lejohet që të vijnë spontanisht deri tek krijimi vetjak muzikor, duke improvizuar ose duke kërcyer sipas përmbajtjes së ofruar.

### ***Mësimi i Kulturës muzikore dhe arsimimi inkluziv***

Mësimi i Kulturës muzikore ofron një spektër të gjerë të veprimtarive për nxënësit me kërkesa të veçanta.

Parë në përgjithësi, karakteristikat e vetë muzikës dhe ndikimi i saj mbi botën emocionale e njohëse të fëmijës dhe mbi zhvillimin e tij psiko-fizik kanë marrë përmasat e hulumtimeve shkencore në fushën e psikologjisë e të psikiatrisë përmes muzikoterapisë e zbatimit të saj. Pa synimin që të merremi me analizën e segmenteve të muzikoterapisë, do të përmendim disa karakteristika kryesore të muzikës, që mund të jenë të dobishme për ju si mësimdhënës.

.....  
1 Për shpjegimin e ecurisë metodike të mësimin të këngës më të dëgjuar si edhe të të gjitha komponentëve të tjerë është përdorur përshkrimi i ecurive që ka dhënë Jozhe Pozhgal në librin e vet "Metodika glazbenog odgoja u osnovnoj školi", Këshilli i Arsimit i Kroacisë, Zagreb, 1975.



Muzika zhvillon aftësinë e gjykimit, aftësinë e të folurit, afirmimin e komunikimit, kontrollin e lëvizjeve, gjendjen e mirë fizike, dëshirën e të mësuarit, socializimin dhe kënaqësinë gjatë punës së përbashkët. Karakteristikat terapeutike të muzikës që zbatohen veçmas tek nxënësit me vështirësi zhvillimi mund të ndahen në disa segmente bazë:

- muzika e përqendron dhe e mban vëmendjen;
- muzika i stimulon dhe i aktivizon shumë pjesë të trurit;
- muzika mund të përshtatet dhe të reflektojë tek personat me mundësi të ndryshme;
- muzika ofron mënyra imagjinare e argëtuese në të cilën e përvetësojmë;
- muzika përmban kontekst të gjerë sociologjik dhe ofron mundësi verbale e jo verbale komunikimi;
- muzika zhvillon kujtesën;
- muzika nxit lëvizjen;
- muzika lidh ndjesinë dhe kujtesën;
- muzika stimulon, sepse në të mund të marrin pjesë të gjithë, pavarësisht nga aftësitë <sup>2</sup>

Hulumtimi neurologjik tregon se në procesin e dëgjimit, të përjetimit e të riprodhimit të muzikës përfshihen disa qendra të sistemit tonë nervor cerebral. Këto hulumtime janë përqendruar sidomos tek personat që kanë vështirësi të caktuara zhvillimi. Rezultatet tek të cilat është arritur tregojnë se disa qendra tek këto persona janë shumë të zhvilluara. Kjo gjë u mundëson atyre dallimin e melodisë, ndjekjen e ritmit ose riprodhimin e muzikës duke kënduar ose me ndonjë instrument. Është dëshmuar se edhe fëmijët me vështirësi në të folur i këndojnë siç duhet fjalët që nuk mund t'i flasim. Kjo gjë tregon se shkathtësitë, realiteti e motivimi muzikor janë të domosdoshme, në mënyrë që këto persona të kenë një zhvillim të caktuar.

Muzikoterapia ka si qëllim zhvillimin e aftësive jomuzikore, në dallim me pedagogjinë muzikore, e cila ka si qëllim zhvillimin e aftësive muzikore.


Mënyrat me të cilat mund t'i motivoni nxënësit me kërkesa të veçanta për pjesëmarrje në mësimin e Kulturës muzikore janë:

- Dëgjimi me përjetim i muzikës e stimulon vëmendjen. Shfaqja e përjetimit përmes vizatimit spontan është një nga mënyrat. Nxënësit i jepni lapsat me ngjyra dhe ai e ndjek muzikën me vijë. Lëreni ta heqë vijën e t'i zgjedhë ngjyrat spontanisht, ashtu siç i ndjen. Shfaqja e përjetimit përmes lëvizjes spontane (në këtë rast përfshijini edhe nxënësit e tjerë, në mënyrë që ai ta ndjejë se i përket grupit).
- Këngët e numërimit përshpejtojnë shqiptimin e drejtë të rrokjeve dhe kuptimin e ritmit. Ato veprojnë me sukses sidomos tek nxënësit me të meta në të folur.
- Të kënduarit përshpejton tek të gjithë shqiptimin e drejtë të fjalëve, frymëmarrjen e drejtë gjatë të kënduarit, përjetimin, vëmendjen dhe zhvillimin e muzikalitetit.
- Lojërat muzikore përshpejtojnë motorikën, socializimin dhe aftësinë për të kryer njëkohësisht disa veprimtari (të kënduarit dhe kërcimin, të kënduarit dhe ndjekjen e ritmit me rrahjen e shuplakave, me trokitje ose me instrumentet e Orfit). Nëse keni nxënësin/nxënësen me të meta në lëvizje, mund t'i jepni ndonjë prej instrumenteve të Orfit, me të cilin do ta ndjekë ritmin, ashtu sikurse edhe nxënësit e tjerë.
- Tek nxënësit me çrregullim autizmi, zbatimi i muzikoterapisë është treguar veçmas produktiv. Thënë në përgjithësi, natyra jo verbale dhe jo agresive e muzikës është medie e favorshme për përjetim, për përgjigjen emocionale të së dëgjuarës, për lidhjen midis së dëgjuarës e pamoresh përmes ilustrimit a regjistrimit me nota. Të kënduarit, thelbi i të cilit është tek melodia dhe jo tek fjalët, sjell edhe deklamimin e fjalëve. Përmes lojës muzikore, lëvizjes, ritmit e melodisë, me një fjalë përmes disa elementeve të lojës, fëmija me këtë lloj çrregullimi mund të bëhet pjesëmarrës duke u përfshirë gradualisht në grup.

Ka rëndësi të thuhet se udhëzimet e dhëna janë vetëm propozime të pedagogëve të muzikës dhe jo të psikoterapeutëve ose të specialistëve që merren me muzikoterapi. Kemi dashur të tregojmë vetëm disa njohuri, tek të cilat është arritur në muzikoterapi dhe t'u nxjerrim në pah mundësitë që muzika u ofron të gjithëve, pavarësisht nga prirjet dhe nga aftësitë.

.....

2 Betsey King, Music Therapy, Future Horison; Arlington, USA, 1999.



## ***Kompleti mësimor “Mrekullia e muzikës 2”***

Teksti mësimor, Libri i mësuesit,  
CD<sup>ja</sup> për nxënësit dhe CD<sup>ja</sup> për mësuesit.

Teksti mësimor “Mrekullia e muzikës 2” është i ndarë në katër kapituj, ashtu siç është bërë kjo gjë edhe për tekstin e klasës së parë. Kapitujt mbajnë emërtimin e stinëve të vitit. Për disa këngë është ofruar paraqitja me ilustrim e vijës melodike. Qëllimet janë paraqitur me ilustrimin e vogëlushit e të vogëlushes (të Enës e të Gjonit), ndërsa me ilustrimin e altoparlantit në këndin e majtë, poshtë, është dhënë propozimi për pjesën që mund të dëgjohet.

Libri i mësuesit ofron zgjidhjet për materialin për çdo temë mësimi. Siç është thënë kjo gjë edhe në Hyrje, këto zgjidhje janë vetëm propozime të grupit të autorëve. Programi mësimor ju ofron mundësi që ta bëni vetë përzgjedhjen e përmbajtjes dhe që pesë orë mësimi gjatë vitit t’i mendoni sipas kërkesave të nxënësve ose të komunitetit lokal (për shembull, këngët popullore të grupit etnik shumicë). Libri i mësuesit përmban më shumë materiale në raport me fondin vjetor të orëve të mësimi, gjë që u mundëson që ta hartoni Planin vjetor. Theksojmë se duhet të tregoni kujdes për t’i përfshirë të gjitha qëllimet mësimore të parashikuara me Program. Pavarësisht, nëse do të vendosni për një realizim ndryshe të orës së mësimi, baza metodike e udhëzimit duhet të respektohet.

CD-ja përfshin këngët artistike e popullore të orkestruara siç duhet të parashikuara për interpretim, si edhe versionin e tyre instrumental e vokalo-instrumental. Përveç këtyre këngëve, CD-ja për mësuesit përmban edhe propozimet e pjesëve për dëgjim. Në orkestrimin e këngëve është treguar kujdes që të jenë të pranishme instrumentet e Orfit dhe instrumentet klasike që përdoren në klasën e parë dhe të dytë (pianoja, violina, tromba, kitara, fizarmonika, flauti). Lidhja me lëndët e tjera të mësimi është dhënë përmes këngëve artistike, përmbajtja e të cilave u përgjigjet temave përkatëse që zhvillohen (festat, miqësia, ekologjia).

Duke ndjekur udhëzimet në Librin e mësuesit, mund t’i mësoni edhe ato këngë që ju duken të vështira me dëgjim të parë. Në CD-në për nxënësit është bërë përzgjedhja me materiale të ndryshme tingujsh.



# VJESHTA KËNGËTARE




# MIRË SE ERDHËTI

Teksti: J. M. Bogojeviq  
Muzika: M. Papiq

Vivo




Mir' se er-dhët vo - gë - lu- shë, nxë - nës je - ni tho - të gjith - kush.



Shkro - njat një nga një i më - so, shkri - min bu - kur ti e shë - no.

Nu - mra, shkro - nja do më - so - ni, a-ven-tur' të re që do - ni.



Dhe mu - zi - ka të je - ho - jë, ze - mrën tën - de ta gë - zo - jë.

Dë - shir' ke - mi që çdo më - sim, të ju sjë - llë ve - tëm gë - zim



Që çdo kë - ngë e me - lo - di, le të jet' për ju mre - ku - lli.

## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësjë duhet:  
- të zhvillojë muzikalitetin

**Incizimi:** "Mirë se erdhët", teksti: J. M. Bogojeviq, muzika: M. Papiq (CD<sup>e</sup> 1, nr. 1)

## Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës me shoqërim ritmik (rrahja e shuplakave mbi gjunjë)

## Udhëzime

1. Mësuesi/mësuesja prezanton shkurtimisht Tekstin mësimor, lexon fjalën hyrëse të autoreve dhe thekson se gjatë këtij viti shkollor do të mësojnë një numër të madh këngësh e vallesh, si edhe do të dëgjojnë muzikë të këndshme dhe do të njohin instrumente të reja. Për të krijuar atmosferën e hareshme, nxënësit këndojnë këngën e tyre të preferuar të vitit të shkuar shkollor.
2. Nxënësit e mësojnë këngën me anë të veshit muzikor, sipas ecurisë së përcaktuar metodike.<sup>3</sup>
3. Nxënësit, duke e kënduar këngën, e ndjekin ritmin me rrahjen e alternuar të shuplakave mbi gjunjë (e majta mbi gjurin e majtë, pastaj e djathta mbi të djathtin).  
P.sh. *Mir' se erdhët* – dora e majtë rreh gjurin, *vogë* – dora e djathtë rreh gjurin, lush dora e majtë rreh gjurin, *pausa* – dora e djathtë rreh gjurin ..., d.m.th. goditja në çdo notë katërshe brenda masës.


.....

3 Ecuria metodike e mëimit të këngës me të dëgjuar është dhënë në Hyrje



## ÇADRA

Autori: M. Mershnik



## VJESHTA

Teksti e muzika: J. M. Bogojeviq



### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të ushtrohet në shqiptimin e rrokjeve me rrahjen e shuplakave, me mërmëritje, me trokitje
- të zhvillojë muzikalitetin dhe idenë për ritmin

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës së numërimit
3. Interpretimi i këngës së numërimit duke ndjekur ritmin (me trokitjen me laps mbi tavolinë).
4. Mësimi i këngës
5. Interpretimi i këngës.

**Incizimi:** "Vjeshta", teksti dhe muzika: J. M. Bogojeviq (CD<sup>e</sup> 1, nr. 4, 5)

### **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja kërkon nga nxënësit që t'i ndajnë fjalët në rrokje (p.sh.: vje-shta, mu-zi-ka, kë-nga). Në po të njëjtën mënyrë do ta mësojnë këngën e numërimit "Çadra".
2. Mësuesi/mësuesja shqipton në mënyrë të njëtrajshme tekstin e këngës së numërimit "Çadra", ndërsa nxënësit përsëritin pastaj (pjesë për pjesë).
3. Nxënësit interpretojnë këngën e numërimit duke e ndjekur ritmin me rrahjen e lapsit mbi tavolinë sipas orkestrimit të dhënë.
4. Pason mësimi i këngës "Vjeshta" me anë të veshit muzikor, sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
5. Interpretohet kënga e shoqëruar me interpretimin instrumental nga CD-ja.



## NË OBORRIN E SHKOLLËS

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të zgjerojë njohjen e ngjyrave të timbrit të tingujve

**Incizimi:** “Në oborrin e shkollës”, teksti: B. Durkoviç (CD-ë 1, nr. 3)

Tingujt e improvizuar: vërshëllima e erës, kërcitja e gjetheve gjatë ecjes, zhurma e fëmijëve, buçima e dallgëve, cicërima e zogjve, imitimi i zërit të pulës, lopës e deles, uturima e motorit, tingëllimi i bilbilit, zëri i mësueses, zilha e shkollës.

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Interpretimi i këngës së numërimit “Çadra”
3. Dëgjimi i tekstit dhe njohja e tingujve

### **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja kërkon nga nxënësit që të mbajnë qetësi, ndërsa pastaj prodhon tinguj të ndryshëm (fëshfërin me qesen e najlonit, troket me laps mbi tryezë ...). Nxënësit nxjerrin përfundimin se mësuesi/mësuesja prodhon tinguj të ndryshëm dhe shpjegojnë se ç’është tingulli dhe si mund të jetë ai.
2. Interpretohet kënga e numërimit “Çadra” e orës së mëparshme. Mësuesi/mësuesja i nxit nxënësit që të tregojnë, sesi mund të bjerë shiu: të regëtijë, të zbrazet rrëke, të pikojë, të përplasat në dritare. Ai/ajo thekson se ky është tingulli që prodhojnë dukuritë e natyrës.
3. Nxënësit dëgjojnë tekstin e incizuar. Pas çdo fjalie, nxënësit emërtojnë qenien ose sendin që i prodhon tingujt që kanë dëgjuar.



# OJ GOCE, OJ GOCE

Ngadalë Këngë popullore nga Mali i Zi



Oj goce, oj goce, moll' arit ti na je.  
Për atë, për atë, tok' edhe atë qiell,  
A do ti, a do ti tjetrin apo mua?

Për atë, për atë tokë edhe atë qiell e tokë,  
S'dua kënd, s'dua kënd tjetër, për veç teje.  
Por prej tash, por prej tash as ty s'të dua më.

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të njihet me krijimtarinë muzikore popullore
- të dallojë instrumentin popullor, fyellin, sipas ngjyrës së tingëllimit

**Incizimi:** "Oj goce, oj goce", këngë popullore nga Mali i Zi (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 8, 9)

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i muzikës
3. Mësimi i këngës
4. Interpretimi i këngës me shoqërimin instrumental nga CD<sup>ja</sup>.
5. Mësimi i hapave
6. Kërcim me shoqërimin vokalo-instrumental nga CD<sup>ja</sup>.


## **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja këndon me rrokje neutrale (na ose la) këngën popullore që zgjedh nga klasa e parë (p.sh. Nën atë ...). Nxënësit duhet të dallojnë dhe të sqarojnë pse quhet ajo këngë popullore dhe thonë instrumentin popullor që kanë njohur vitin e kaluar shkollor (lahuta).
2. Pas një bisede të shkurtër, nxënësit dëgjojnë incizimin e fyellit dhe shohin ilustrimin në Tekstin mësimor: Mësuesi/mësuesja shpjegon se ky është instrument popullor prej druri, karakteristik për Malin e Zi.
- 3 e 4. Nxënësit e mësojnë këngën me anë të veshit muzikor sipas ecurisë së përcaktuar metodike, e pastaj e këndojnë të shoqëruar me interpretimin instrumental nga CD<sup>ja</sup>.
5. Mësuesi/mësuesja demonstroi hapat dhe nxënësit i përsëritin pastaj ato.

## **Propozim për koreografinë:**

- Oj goce, oj goce* – dy hapa djathtas me këmbën e djathtë, duke tërhequr të majtën (e djathta-e majta-e djathta-e majta).
- moll' e* – një hap majtas me këmbën e majtë, duke tërhequr të djathtën (e majta-e djathta).
- bukuro* – tre hapa në vend (e majta-e djathta-e majta). Strofat e tjera paraqiten njëilloj.
6. Nxënësit e interpretojnë koreografinë me shoqërimin vokalo-instrumental nga CD<sup>ja</sup>.

**Shënim:** Në këtë propozim për realizimin e orës së mësimi është parashikuar që, krahas punimit të këngës, të bëhet edhe koreografia e thjeshtë. Nëse kënga punohet me një melodi më të ndërlikuar, koreografia mund të punohet orën e ardhshme të mësimi.



## AJ, BAJ

Aj, baj, ti mos qaj, ti - je mi - je kom - pa - ni - je,  
5 Gje - li, gje - li pa - ra - sum e, aj, baj, bum!

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të ushtrohet në shqiptimin e rrokjeve me rrahjen e shuplakave, me mërmëritje
- me trokitje të zhvillojë muzikalitetin dhe idenë për ritmin

### **Hapat kryesorë**

1. Përsëritja e këngës së numërimit
2. Mësimi i këngës së numërimit

### **Udhëzime**

1. Nxënësit përsëritin ndonjë këngë numërimi të mësuar vitin e kaluar shkollor.
2. Pason mësimi i këngës së numërimit sipas ecurisë së përcaktuar metodike duke ndjekur orkestrimin e Tekstit mësimor me rrahjen e alternuar të shuplakave mbi bankë.



# EC, ROSAK I VOGËL

Mesatare Teksti: G. Tartala  
Muzika: I. L. Kalinski



Ky ro - sa - ku çap çup, për di - ku udh' - ton.  
Bi - shtin e tund nga pak, sqe - pi i zver - dhon.

5 Për - shën - det si ush - tar: tra - ta ra - ta - ta,

9 Të la - het është ni - sur, tho - të "kva, kva, kva"!

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin
- të modelojë zërin e të kënduarit
- të dallojë me të dëgjuar këndimin solo e në grup
- të përcaktojë nocionin solist e kor.

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës së numërimit me shoqërim të incizimit

**Incizimi:** "Ec, rosak i vogël", teksti: G. Tartala, muzika: I. L. Kalinski (CD<sup>e</sup> 1, nr. 11, 12)

## **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja kërkon nga nxënësit që të imitojnë zërat e kafshëve (lopa, macja, qeni, bleta, delja, rosa ...), ndërsa pastaj lexon tekstin e këngës "Ec rosak i vogël".
2. Pason mësimi i këngës "Ec rosak i vogël" sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Nxënësit e këndojnë këngën me shoqërimin e incizimit, pastaj e këndojnë në grupe të vogla, në duet a solo. Mësuesi/mësuesja shpjegon kuptimin e fjalëve solist e kor.

(Solisti është person që këndon ose që interpreton; kori është grupi i madh i këngëtarëve që këndojnë së bashku.)

*Shënim: Në kuadër të kësaj ore mësimi mësuesi/mësuesja mund të punojë këngën e numërimit "Aj, baj", për të cilën janë dhënë udhëzimet në orën e mëparshme.*







3. Këndohet kënga.

4. Mësuesi/mësuesja i demonstroi hapat, ndërsa nxënësit e imitojnë.

**Përshkrimi i valles:**


Strofa I: 16 hapa djathtas, me tërheqjen e këmbës së majtë (këmba e djathtë është pak para së majtës),

Strofa II: 16 hapa majtas, me tërheqjen e këmbës së djathtë (këmba e majtë është pak para së djathtës).

Interpretohet "Vallja e Eros" duke e kënduar.

## ROZA THURTE FLOKT' E ARTË

Allegro Këngë popullore nga Mali i Zi



Ro - za thur - te flokt' e ar - të, haj - de haj - de, top - çe, haj - de qen - gji.

Roza nënës po i thoshte  
hajde, hajde topçe,  
hajde, hajde qengji.

**Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin, të modelojë zërin e të kënduarit dhe të zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit

**Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës

**Incizimi:** "Roza thurte flokt' e artë", këngë popullore nga Mali i Zi (CD<sup>e</sup> 1, nr. 16, 17)

**Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja i nxit nxënësit që të thonë disa këngë popullore të mësuara dhe të këndojnë ndonjë prej tyre. Bisedojnë për atë që u pëlqen veçmas tek këto këngë, p.sh.: teksti, muzika...
2. Pason mësimi i këngës "Roza thurte flokt' e artë" me vesh, sipas ecures metodike të përcaktuara.
3. Nxënësit e këndojnë këngën me shoqërim instrumental nga CD<sup>ja</sup>.



# JA, KËSHTU...

Valle popullore e kënduar nga Mali i Zi



M: Shih - ni se - si\_ nxi - rret u-ji , ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
F: S'është' a - shtu\_ por kësh - tu, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
M: Shih - ni se - si\_ zbar - dhen rro-bat, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
F: S'është' ash - tu\_ por kësh - tu, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
M: Shih - ni se - si\_ mbi - llet gru - ri, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
F: S'është' ash - tu\_ por kësh - tu, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
M: Shih - ni se - si\_ ko - rret gru - ri, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu.  
F: S'është' ash - tu\_ por kësh - tu, ja kë-shtu\_ ja kë-shtu

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të fitojë njohuri se përmes valleve muzikore mësohet si të ushtrohet zëri dhe si të shoqërohem

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Ndarja në grupe
4. Dramatizimi i tekstit
5. Dramatizimi i këngës në duet

## **Udhëzime**

1. Në pjesën hyrëse të orës së mësimit nxënësit këndojnë këngën "Roza thurte flokt' e artë"
2. Nxënësit mësojnë këngën "Ja kështu ..." sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
- 3 e 4. Mësuesi/mësuesja i ndan nxënësit në dy grupe të vendosura përballë njëri-tjetrit:  
Grupi I këndon e dramatizon tekstin - *Shihni sesi nxirret uji, ja kështu, ja kështu.*  
Grupi II këndon e dramatizon tekstin - *S'është' ashtu, por kështu, ja kështu, ja kështu.*  
Vazhdohet kështu deri në fund të këngës. Grupet e interpretojnë të kënduarit duke u alternuar me dramatizim.
5. Në fund të orës së mësimit, mësuesi ose mësuesja zgjedh katër duete që ta interpretojnë dramatizimin e këngës.



## KAP RITMIN

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- t'i krijojë vetë hapat
- të zhvillojë idenë për ritmin

### **Incizimi:**

e ngadaltë; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 20

mesatare; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 21

e shpejtë; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 22

vals; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 23

balet; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 24

valle; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 25

"Shota"; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 26

rokenrol; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 27

bluz; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 28

M. Xhekson: "Billi Xhin"; CD<sup>ë</sup> 1, nr. 29

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Ushtrimi i lëvizjeve
3. Lëvizja e shoqëruar me incizimin e regjistruar
4. Dëgjimi i muzikës dhe njohja e ilustrimeve që i përgjigjen këngës së dhënë
5. Përpunimi i hapave

### **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja lëshon dy shembuj të incizuar dhe kërkon nga nxënësit të shpjegojnë se në ç'gjë ndryshojnë (I i shpejtë, II i ngadaltë). Pastaj u shpjegon nxënësve se tempoja është shpejtësia me të cilën interpretohet ndonjë këngë dhe se ajo mund të jetë e ngadaltë, mesatare dhe e shpejtë.
2. Në vazhdim të orës së mësimet, nxënësit ushtrohen në lëvizje duke numëruar deri në katër: katër herë shuplaka mbi shuplakë, katër herë trokitje me gishtërinj, katër herë i rrahin shuplakat mbi gjunjë, katër herë deri në pozicionin galuc dhe katër herë përsëri deri në pozicionin drejtqëndrim.
3. Nxënësit i interpretojnë lëvizjet e mësuara me incizimin me tempo të ngadaltë, mesatare e të shpejtë.
4. Nxënësit dëgjojnë incizimet me tempo të ndryshëm, me qëllim që të dallojnë se cilit kompozim i takon secili ilustrim (valser nr. xy, baleti ...).
5. Mësuesi/mësuesja lëshon këngën e Majkëll Xheksonit "Billi Xhin", ndërsa nxënësit vetë i përpunojnë lëvizjet (me kokë, me duar, me këmbë, me ije).

# DIMRI MAGJIK





# DIMRI

Teksti: L. Rackoviç  
Muzika: M. Papiç



Lam -tu - mi - rë vjesht' e ver-dhë, mir' se vjen di - mër i bar - dhë.  
Bri - tma, thi - rrje në çdo a - në, ga - ti fry - ma na ka nda - lë.

<sup>3</sup>  
Gjith - çka ngrin, me bo - rë ve-shet, gjy - shja kre - na - re po qe - shet.  
<sup>5</sup> Pes' mi - nu - ta ka - në ka - lu - ar, Burr' i bo - rës është mba - ru - ar.

Vër ka - pu - çin, e sha - llin rreth, th'rra - sim sho - kët të gjith' me rend

<sup>7</sup>  
Gë - zi - me dim - ri ne na dhu - ron, bo - ra e bardh' rru - gët i mbu-lon.

## **Qëllimi operativ**

- Nxënësi/nxënësja duhet:
- të zhvillojë muzikalitetin
  - të formësojë zërin e të kënduarit

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës
4. Dëgjimi i muzikës

**Incizimi:** "Dimri", teksti: L. Rackoviç, muzika: M. Papiç (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 31)  
"Idil dimri", interpreton: B. Gjukanoviç (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 32)

## **Udhëzime**

1. Nxënësit bisedojnë për lojërat e dimrit.
2. Pason mësimi i këngës sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Interpretohet kënga në grupe të vogla.
4. Nxënësit dëgjojnë këngën "Idil dimri" dhe ilustrjnë përmbajtjen e saj.



## TË NJOHIM INSTRUMENTET

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të dallojë sipas tingullit e pamjes flautin, kitarën dhe fizarmonikën

**Incizimi:** flaut, kitarë e fizarmonikë (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 33, 34, 35)

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i ngjyrës së tingullit të instrumentit
3. Emërtimi i instrumenteve gjatë dëgjimit

### **Udhëzime**

1. Nxënësit përsëritin instrumentet që kanë mësuar gjatë vitit të kaluar shkollor dhe thonë instrumentet e reja që dinë.
2. Lëshohet incizimi me flaut. Pas kësaj, duke shikuar ilustrimin në Tekstin mësimor, komentojnë pamjen, mënyrën e mbajtjes dhe mënyrën sesi i bihet flautit. Mësuesi/mësuesja shpjegon se flauti është instrument frymor dhe i vetmi që mbahet anash. Toni përftohet duke shtypur butonin dhe duke i fryrë njëkohësisht instrumentit. Nxënësit dëgjojnë incizimin muzikor me flaut dhe komentojnë tingëllimin.  
Lëshohet incizimi me kitarë. Mësuesi/mësuesja shpjegon pastaj se kitara ka 6 tela dhe se tingulli përftohet me dridhjen e telave me gishta ose me dridhëse dhe për këtë arsye ajo i përket instrumenteve dridhëse me tela. Nxënësit dëgjojnë incizimin me kitarë dhe komentojnë tingëllimin.  
Lëshohet incizimi me fizarmonikë. Mësuesi/mësuesja shpjegon se fizarmonika ka tastierën në anën e djathtë dhe baset në anën e majtë. Tingulli përftohet me shtypjen e njëkohshme me gishta në tastierë ose në base në anën e majtë dhe me hapjen e rrëshiqt që gjendet midis anës së djathtë e të majtë të instrumentit. Tingulli s'mund të përftohet, nëse preken tastet, ndërsa rrëshiqi nuk hapet. Nxënësit dëgjojnë incizimin me kitarë dhe komentojnë tingëllimin.
3. Mësuesi/mësuesja lëshon në mënyrë të alternuar shembujt me incizime, ndërsa nxënësit dallojnë tingëllimin e instrumentit.

*Shënim: Nëse ndonjë nga nxënësit ose prindërit e nxënësve i bie ndonjë instrumenti, do të ishte mirë që këtë gjë t'ua demonstronte nxënësve.*



# ËNDRRA

Teksti: L. Rackoviq  
Muzika: M. Papiq




U - lur në ti - mon bret - ko - sa, zog i pu - lës mbi kê hi - pur,  
3 le - pu - ru - shi po ndjek uj - kun, gjith' kjo zhur - më prej nga po vjen?  
Ka - fe pi - në mi e ma - ce, ka - li lo - pa lo - zin në harp',  
5 del - ja dhi - së i thur gër - shet, rro - tull lu - les zu - zu pu - lat.  
Nuk është' zhur-më, veç ën - dërr, shtri - het Jo - le në di - van,  
7 fje - ti Jo - le me - një - her', pa një ën - dërr që mend s'mban.  
9 Kër - cen de - rri va - llen tan - go, bi - ba po - lli fru - tin man - go,  
11 në dor' go - ma - ri li - brin e mban, e gji - thë kjo me bre - ngë më ngjan - te.

## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin
- të formësojë zërin e të kënduarit
- t'i kuptojë nocionet muzikore përmes të dëgjuarit
- të vëre re se kompozimet muzikore "zbulojnë" gjendje shpirtërore, ngjarje, tregime e përralla të ndryshme.

**Incizimi:** "Ëndrra", teksti: L. Rackoviq, muzika: M. Papiq (CD<sup>e</sup> 1, nr. 36, 37)



*Qetësi nate*, ninullë, interpreton kori i fëmijëve “Kolibri”, (CD 1, nr. 38)  
*Nina-nana* - ninullë shqiptare, (CD 1, nr. 39)  
*O kler de la lun* – ninullë franceze (CD1, nr. 40)

### Hapat kryesorë

1. Dëgjimi i muzikës
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës
4. Ilustrimi i këngës së dëgjuar

### Udhëzime

1. Mësuesi/mësuesja lëshon incizimin muzikor të këngës shqiptare “*Nina-nana*”, ndërsa nxënësit duhet të dallojnë interpretuesin (solistin; vajza), kurse pastaj incizimin muzikor të këngës franceze “*O kler de la lun*” me detyrë që ta njohin tempon. Nxënësit dëgjojnë shembullin e incizuar muzikor të këngës “*Qetësi nate*” me detyrë që të bëjnë dramatizimin e tekstit. Mësuesi/mësuesja shpjegon se këngët që kanë dëgjuar quhen këngë djepi dhe se, duke i kënduar, këngët e tilla mund të vëmë në gjumë dikë (p.sh. motrën a vëllanë e vogël).
2. Pason mësimi i këngës “*Ëndrra*” sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Interpretohet kënga.
4. Krahasohet kënga “*Qetësi nate*” dhe “*Ëndrra*”; tempoja dhe karakteri (“*Qetësi nate*” e ngadaltë, e ndjeshme, përkundëse, ndërsa “*Ëndrra*” e shpejtë, e gjallë, e gëzueshme, humoristike).

## GËZIM BORE

Autore: J. M. Bogojeviq



Me sli - ta rrësh - qa - sim, gju - ajm' to - pa bo - re,  
Sa gëz - im që ke - mi, bu - kur e ka - loj - më.

5  
Ka - pu - çët në ko - kë, dor' - za di - më - ro - re,  
Gjith' për - ja - shta, gju - ajm' to - pa bo - re.


### Qëllimi operativ

- Nxënësi/nxënësja duhet:
- të zhvillojë muzikalitetin dhe idenë për ritmin
  - t'i dallojë sipas tingëllimit instrumentet e Orfit

### Hapat kryesorë

1. Këndimi i këngës “*Dimri*”
2. Mësimi i këngës



- 
3. Ndarja në dy grupe
  4. Interpretimi i këngës së numërimit
  5. Interpretimi në duet

#### **Udhëzime**

1. Nxënësit këndojnë këngën "Dimri".
2. Pason mësimi i këngës së numërimit sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Nxënësit ndahen në dy grupe. Një grup interpreton me trokitës, kurse tjetri përdor shkopinjtë. Çdo grup e deklamon këngën e numërimit, duke e shoqëruar me instrumentet e Orfit siç është shënuar në orkestrim.
4. Të dyja grupet e interpretojnë këngën e numërimit së bashku, duke ndjekur orkestrimin në Tekstin mësimor.
5. Kënga e numërimit interpretohet në duet.

*Shënim: Nxënësit mund t'i përgatitin në shtëpi "trokitësit" duke përdorur shishet plastike në të cilat futin: rërë, oriz, guralecë etj. Dy lapsa (me ngjyra ose grafiti) mund t'u shërbejnë si shkopinjtë.*

## SHKOLLA E MUZIKËS

#### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të zgjerojë njohjen e ngjyrave (timbrit) të tingujve
- të zhvillojë përmes të dëgjuarit nocionet muzikore

#### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi dhe njohja e ngjyrave të instrumenteve.
3. Bisedë për instrumentet
4. Dëgjimi i muzikës

**Incizimi:** "Shkolla e muzikës" me tinguj të improvizuar, teksti: L. Rackoviq, (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 41)  
"Shkolla e muzikës", këndon M. Vujadinoviq, (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 42)

#### **Udhëzime**

1. Nxënësit bisedojnë për shkollën e muzikës. Nëse ndonjë nga nxënësit ndjek shkollën e muzikës, ai u shpjegon shokëve e shoqeve se çfarë mëson atje. Mësuesi/mësuesja shpjegon se, nxënësit në shkollën e muzikës mësojnë të këndojnë dhe t'i bien ndonjë instrumenti.
2. Mësuesi/mësuesja lëshon incizimin muzikor "Shkolla e muzikës", ndërsa detyrë e nxënësve është të dëgjojnë me vëmendje, në mënyrë që të dallojnë instrumentet e shkollës së tyre të muzikës (figurat e mbuluara në Tekstin mësimor).
3. Nxënësit tregojnë se cili instrument u pëlqen më shumë dhe pse u pëlqen.
4. Pason dëgjimi i këngës "Shkolla e muzikës", me detyrë që nxënësit ta drejtojnë vëmendjen tek interpretuesit (solisti dhe kori), ndërsa pastaj ta përshkruajnë përjetimin e këngës nga ana e tyre.

*Shënim: I ftuar mund të jetë një nxënës/nxënëse e klasave të larta që ndjek shkollën e muzikës, që të interpretojë ndonjë kompozim të preferuar.*



# PINOKU

Teksti: L. Rackoviq  
Muzika: V. F. Bogiqeviq



"Mos gë - nje, mos gë - nje, o Pi - no - ku im,  
Hu - nda e vo - gël do t' zgja - tet fort."

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të formësojë zërin gjatë të kënduarit
- të dijë se muzikën (kompozimin muzikor) e krijon kompozitori

**Incizimi:** "Pinoku" (CD<sup>e</sup> 1, nr. 43, 44)

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i këngës "Pinoku"
3. Mësimi i refrenit të këngës
4. Interpretimi i refrenit të këngës
5. Nxënësit e këndojnë refrenin e këngës me shoqërimin e incizimit muzikor.




## **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja kërkon nga nxënësit që të kujtojnë librin për lexime jashtë klase "Pinoku". Bisedojnë për përmbajtjen e tregimit, për personazhet dhe për karakteristikat e tyre. Mësuesi/mësuesja u shpjegon nxënësve se përmbajtja e tregimit ka shërbyer si frymëzim për poeteshën për ta shkruar tekstin në vargje; këngën, ndërsa pastaj, kompozitori ka kompozuar muzikën për tekstin e dhënë. Mësuesi/mësuesja shpjegon se kompozitori/kompozitorja është personi që krijon muzikë.
2. Pason dëgjimi i këngës "Pinoku".
3. Nxënësit mësojnë refrenin e këngës sipas ecuresë së përcaktuar metodike.
4. Nxënësit e këndojnë refrenin e këngës.
5. Me shoqërimin e incizimit nga CD<sup>ja</sup>, nxënësit këndojnë refrenin e këngës.

*Shënim: Meqë kënga është e vështirë për t'u kënduar, nxënësit duhet ta këndojnë vetëm refrenin.*

# MBRËMJE MAGJIKE

Teksti: J. M. Bogojeviq  
Muzika: V. F. Bogiqeviq



## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin

- të formësojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit



### Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës

**Incizimi:** "Mbrëmje magjike", teksti: J. M. Bogojeviq, muzika: V. F. Bogiqeviq (CD 1, nr. 45, 46)

### Udhëzime

1. Nxënësit bisedojnë për Vitin e Ri dhe për frymën që ekziston në Natën e Vitit të Ri. Në pjesën hyrëse mësuesi/mësuesja mund të lëshojë incizimin muzikor të këngës "Dëshirat e Vitit të Ri" që gjendet në CD-në "Mrekullia e muzikës 1" për klasën e parë.
2. Mësimi i këngës me të dëgjuar sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Nxënësit interpretojnë këngën.

## KONCERTI I VITIT TË RI

### Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të përvetësojë nocionin orkestër e dirigjent;
- të dallojë me anë të veshit muzikor këndimin solo dhe atë në grup.

### Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i nocionit "orkestër" dhe "dirigjent"
3. Dëgjimi i muzikës
4. Shprehja e përjetimit muzikor

**Incizimi:** J. Shtraus "Tregime nga pylli i Vjenës", vals; fragment (CD<sup>e</sup> 1, nr. 47)

1. Nxënësit bisedojnë për atë se ç'është koncerti, ku mbahet më shpesh ai, si mund të jetë koncerti, si duhet të sillt publiku në një koncert të muzikës klasike. Mësuesi/mësuesja i njej nxënësit se ekzistojnë edhe koncertet që mbahen gjithandej në botë, në prag të festave të fundvitit. Koncerti më i njohur është ai që mbahet në Vjenë.
2. Nxënësit komentojnë ilustrimin. Përvetësojnë nocionet; *orkestër*, *dirigjent*. Orkestra është një grup i madh interpretuesish që u bien së bashku instrumenteve muzikore. Dirigjenti është artisti që e udhëheq a që e dirigjon orkestrën, që u jep shenjë interpretuesve, kur dhe si duhet t'u bien instrumenteve muzikore.
3. Nxënësit dëgjojnë incizimin muzikor.
4. Në fund duhet ta shprehin përjetimin e vet të muzikës që kanë dëgjuar, të thonë se ç'tempo e karakter ka ajo.

**Shënim:** Mësuesi/mësuesja mund të zhvillojë brenda një ore mësimi temat "Mbrëmje magjike" dhe "Koncerti i Vitit të Ri".



## GJENDJE TË NDRYSHME SHPIRTËRORE

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të vërejë se kompozimet muzikore “zbulojnë” gjendje shpirtërore, ngjarje, tregime e përralla të ndryshme

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i tingujve të incizuar
3. Komentimi i ilustrimit në Tekstin mësimor
4. Dëgjimi përsëri i tingujve të incizuara me renditje tjetër
5. Dallimi i karakterit të muzikës dhe lidhja me ilustrimin e caktuar

### **Incizimi**

gëzueshëm: Zh. Ofenbah “*Kan-kan*” (CD 1, nr. 48)

trishtueshëm: J. S. Bah “*Aria*”, e përpunuar (CD 1, nr. 49)

ëndërruese: J. Brams “*Natën e mirë*” (CD 1, nr. 50)

frikësuese: I. Stravinski “*Himn pranverës*”, fragment (CD 1, nr. 51)

solemne, festive: V. A. Moxart “*Muzikë e vogël nate*”, fragment (CD<sup>e</sup> 1, nr. 52)

### **Udhëzime**

1. Në pjesën hyrëse të orës së mësimimit, mësuesi/mësuesja bisedon me nxënësit për të gjitha ndjesitë që zgjon muzika.

2. Nxënësit dëgjojnë fragmentin e kompozimit dhe pas çdo fragmenti bisedojnë për gjendjen shpirtërore që u ka shkaktuar muzika (gjendje trishtuese, të gëzuar, ëndërruese, festive, frikësuese).

3. Pas kësaj nxënësit shohin ilustrimet, shprehjen e fytyrave në to dhe komentojnë se çfarë gjendjesh shpirtërore pasqyrojnë ato.

4 e 5. Nxënësit dëgjojnë përsëri incizimet muzikore me një renditje ndryshe dhe sipas përjetimit vetjak të muzikës lidhin atë që dëgjojnë me ilustrimin përkatës.

*Shënim: Mësuesi/mësuesja nuk do të duhej t’u sugjeronte nxënësve se cili është karakteri i kompozimit. Nuk është e domosdoshme që të dëgjojnë të gjitha incizimet muzikore, por, në vartësi të dinamikës së orës së mësimimit dhe të intensitetit të vëmendjes së nxënësve, të bëjë përzgjedhjen e kompozimeve. Nëse nxënësit e përjetojnë kompozimin ndryshe nga ajo si është përcaktuar kjo gjë në karakterizimin tonë, ata nuk duhet të korrigjohen. Rëndësi ka që nxënësi/nxënësjë ta përjetojë muzikën dhe ta zgjedhë ilustrimin sipas përjetimit vetjak.*



## ÇFARË KEMI MËSUAR?

### *Sistemimi i lëndës së mësuar*

Përmes llojeve të ndryshme të lojërave, siç janë kuizët, gjëegjëzat e pantomimat, nxënësit mund ta përsëritin lëndën e mësuar tashmë.


### *Udhëzime:*

1. Nxënësit dëgjojnë incizimin muzikor të versioneve instrumentale të këngëve dhe gjejnë se për cilat këngë bëhet fjalë.
2. Një nxënës/nxënëse e këndon këngën me rrokje neutrale. Nxënësit e tjerë duhet që ta njohin këngën. Nxënësi/nxënësja që e njih e para këngën, këndon këngën e dytë në të njëjtën mënyrë, ndërsa nxënësit e tjerë e njohin.
3. Nxënësit mund të ndahen në grupet që do të bëjnë garë në të kënduar. Mësuesi/mësuesja i cakton anëtarët e jurisë. Grupet bëjnë garë në interpretimin e këngëve. Disa këngë i këndojnë të gjithë, ndërsa disa i këndojnë solistët. Juria ndan pikët, të cilat në fund i mbledhin dhe shpall grupin fitues.
4. Nxënësit luajnë pantomimën dhe imitojnë interpretimin me instrumente. Përveç instrumenteve që kanë mësuar në semestrin e parë (flauti, kitara, fizarmonika), ata përsëritin edhe instrumentet që kanë mësuar në klasën e parë (violina, pianoja dhe tromba).
5. Nxënësit, duke i dëgjuar kompozimet, mund të bëjnë lëvizje spontane, të përpunojnë koreografinë ose të shprehen në mënyrë figurative. Kompozimet me shpejtësi (tempo) ose të karaktereve të ndryshme (të gëzuara, trishtuese, frikësuese, përkundëse) mund të shprehen me ngjyra dhe me vijë lëvizëse. Nxënësi/nxënësja bën vija në letër gjatë leximit, i/e prirë nga përjetimi vetjak i muzikës. Kjo veprimtari mund të zhvillohet edhe në orën e mësimin të Kulturës së artit figurativ, si formë e lidhjes ndër-lëndore midis këtyre dy lëndëve të mësimin.
6. Me të gjitha incizimet muzikore të këngëve artistike e popullore të parashikuara për t'u kënduar mund të shfrytëzohen instrumentet e Orfit ose të ndiqet ritmi me trokitje, me murmuritje dhe me përplasjen e shuplakave. Nxënësit mund t'i deklamojnë këngët e numërimit të mësuara dhe ta përpunojnë vetë shoqërimin ritmik. Përpunimi i ritmit do të duhej të zhvillohej në grupe të vogla. Çdo grup demonstroi veçmas këngën e numërimit me shoqërimin që kanë përpunuar vetë.
7. Nxënësit mund të bëjnë ekspozitën e punimeve të krijuara si pasqyrim figurativ i përjetimit muzikor (emërtimet e mundshme të ekspozitës janë: Muzika e pikturuar, Piktura muzikore, Të pikturojmë muzikën; Muzika me ngjyra).

Këto udhëzime mësuesi/mësuesja mund t'i plotësojë me veprimtari të tjera që janë dhënë në Programin mësimor për klasën e dytë.

*Shënim: Mësuesi/mësuesja duhet ta bëjë sistemimin e lëndës së mësuar përmes formave të paraqitura të punës në fund të semestrit të parë e të dytë.*

# PRANVERË E HARESHME





# LULEBORA

Teksti dhe muzika: S. Korunoviq



1. Mbi ba - rin e but' e t'njom, gë - zu - ar buz' -qe - shet
2. Pak për-ku-lur ko - kën mban, e - rës pak i tre - mbet.
3. Pe - ta - let fort i zbar - dhojn' mbi ba - rin e gjel-bër.



- kë - sul'- gjel - bër ësh - të a - jo, por vog'- lu - she s'ë - shtë.  
lu - le - bo - ra ë - shtë kjo që në fu - shë qën-dron  
ma - nu - shaq -ja pra - në saj shkël - qen po - si qie - lli

## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të formësojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të kuptojë se të gjithë, pavarësisht nga muzikaliteti, e përjetojnë muzikën

**Incizimi:** "Lulebora", muzika dhe teksti: S. Korunoviq (CD-ë 2, nr. 1, 2)

## Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Këndimi i këngës
4. Dramatizimi i këngës

## Udhëzime

1. Nxënësit përsëritin këngët që kanë mësuar gjatë vitit shkollor.
2. Pason mësimi i këngës sipas ecures së përcaktuar metodike (mësuesi/mësuesja këndon ose interpreton me instrument nga dy masa, ndërsa nxënësit përsëritin. I lidhin nga dy masa deri sa ta përvetësojnë gjithë këngën).
3. Nxënësit interpretojnë gjithë këngën.
4. Nxënësit dramatizojnë gjithë këngën.

**Përshkrimi i valles:** Nxënësit kapen në valle.

Strofa e parë: Përkulen dhe tregojnë barin e butë, pastaj drejtohen, tregojnë kësulën e gjelbër dhe tek vargu "por vog'lushe s' është" e tundin në mënyrë mohuese gishtin tregues të dorës së djathtë.

Strofa e dytë: Ulin kokën dhe tregojnë me duar se fryn erë.

Strofa e tretë: Tregojnë me duar manushaqen në barin e gjelbër dhe kaltërsinë e qiellit.

**Shënim:** Çdo strofë e kënduar mund të këndohet edhe një herë me rrokje neutrale (la, na) me lëvizjen e valles në anën e djathtë.





# UJI RRIDHTE VALË-VALË

**Andante** Këngë popullore nga Mali i Zi



U - ji rri - dhete va - lë - va - lë, o, çe - ti - na kry - e - lar - të.

Diku rridhte, diku humbte,  
o çetina kryelartë.  
Gjith' e pinë kuajt azgan',  
o çetina kryelartë.  
Kuajt azgan' dhe dasmorët  
o çetina kryelartë.

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

1. të modelojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
2. të zotërojë lëvizjet kryesore të valleve muzikore tradicionale
3. t'i kuptojë nocionet muzikore

**Incizimi:** "Uji rridhte valë-valë", këngë popullore nga Mali i Zi (CD<sup>ë</sup> 1, nr. 4, 5)

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës
4. Interpretimi i këngës me alternimin e solistit e të korit

## **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja lëshon incizimin muzikor instrumental të këngëve popullore të mësuara. Nxënësit i njohin ato, ndërsa pastaj i këndojnë. Përmes këngëve popullore, nxënësit mësojnë të këndojnë në mënyrë shprehëse dhe ta përjetojnë përmbajtjen muzikore.
2. Pason mësimi i këngës sipas ecurisë së përcaktuar metodike (dy nga dy masa). Mësuesi/mësuesja u shpjegon nxënësve se çdo varg e shoqëron përsëritja "O çetina kryelartë".
3. Nxënësit/nxënëset interpretojnë këngën.
4. Pas mësimit të këngës, një nxënës këndon strofën, ndërsa të tjerët (si kor) këndojnë vargun që përsëritet "O, çetina kryelartë". Mund të veçohet një nxënës ose një nxënëse që do të këndonte nga një strofë, kurse të tjerët do të këndonin vargun që përsëritet "o çetina kryelartë". Përmes një mënyrë të tillë këndimi, përsëritin se ç'është interpretimi në kor dhe ç'është interpretimi solo (grupi i madh i këngëtarëve/këngëtareve është kori; një këngëtar/këngëtare është solisti).

# NËNA

Teksti: J. M. Bogojeviq  
Muzika: V. F. Bogiqeviq



A - jo mua me gji - thë ze - mër më do, dhe da - shu - ri pa  
4 Dhe për këtë në-nës da-shu-rin' kthe-ja, je-pja mir'-sin' dhe  
fund më dhu - ron, ë - shtë a - ty për çfar'- do ne - vo -je  
7 da - shu - ri - në, gjith - kush prej nesh këtë du - het ta di - jë  
për të ë-shtë sot ky trën - da - fil.  
10 Veç një në - në ke - mi, tje - tër s'ke - mi.  
A - jo ë - shtë në - na që të sjell në jet', a - jo ë - shtë në - na që  
13 të fal ty gjith - çka, mi - ku që t'udh' - heq gjat' je - tës të - nde  
16 t'ru - an, të le - dha - ton, me ty ënd' - rron.

## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të zhvillojë muzikalitetin dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të mësojë të këndojë me zë të lartë e me zë të ulët

**Incizimi:** "Nëna", teksti: J. M. Bogojeviq, muzika: V. F. Bogiqeviq (CD<sup>e</sup> 2, nr. 6, 7)



### Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i incizimit muzikor të këngës “Nëna”
3. Mësimi i këngës
4. Interpretimi i këngës

### Udhëzime

1. Mësuesi/mësuesja bisedon me nxënësit për ditët e festave dhe çfarë festash mund të jenë (familjare, shtetërore, fetare).

Cila është festa e preferuar e nxënësve dhe pse është e preferuar? Mësuesi/mësuesja bën të ditur mësimin e këngës “Nëna”, të cilën ia dedikojmë qenies më të dashur për festën e saj, 8 Marsin.

2. Në vazhdim të orës së mësimin, mësuesi/mësuesja lëshon incizimin muzikor të këngës “Nëna”. Ai/ajo zhvillon një bisedë të shkurtër për përshtypjet e para.

3. Pason mësimi i këngës me anë të veshit muzikor sipas ecures së përcaktuar metodike.

4. Nxënësit interpretojnë këngën me nuancime dinamike (p.sh. strofa e parë ulët, refreni lart, strofa e tretë ulët). Duhet synuar që nxënësit të këndojnë në mënyrë sa më shprehëse.

## DALLËNDYSHJA

Autori: M. Mershnik



Da - llë - ndy - she ku ke qe - në, prej nga kra - hët

të kan' sje - llë? Ve - ra e gja - të, në jug të

bo - tës, dim - rit i - ki larg, në pran - ver' kthe - hem prap'.

### Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të ushtrohet në shqiptimin e rrokjeve me rrahjen e shuplakave, me mërmëritje, me trokitje
- të fitojë njohuri se përmes valleve muzikore, mësohet si të shoqërohem

*Incizimi: "Mollëkuqja dhe brumbulli"; interpreton Elma Koshuta (CD<sup>e</sup> 2, nr. 3)*



### Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës së numërimit
3. Interpretimi i këngës së numërimit
4. Dramatizimi i këngës "Mollëkuqja dhe brumbulli"

### Udhëzime

1. Nxënësit bisedojnë për ardhjen e pranverës, për lajmëtarët e saj, si edhe për zogjtë që kthehen nga viset e ngrohta. Përsëritin se cilët zogj kanë mundur të shohin gjatë dimrit dhe cilët janë kthyer në pranverë. Mësuesi/mësuesja bën të ditur mësimin e këngës së numërimit "Dallëndyshja"
- 2 e 3. Në vazhdim të orës së mësimin, mësuesi/mësuesja e interpreton këngën e numërimit duke e deklamuar ritmikiisht tekstin me rrokje dhe duke e shoqëruar ritmin me trokitje me gishtërinj. Pas kësaj, nxënësit e përsëritin këngën e numërimit në të njëjtën mënyrë. Kënga e numërimit mund të interpretohet edhe me instrumentet e Orfit.
4. Mësuesi/mësuesja u lexon nxënësve përmbajtjen e këngës " Mollëkuqja dhe brumbulli". Bisedojnë për sjelljen e bukur, çfarë themi kur fyejmë dikë, si duhet të kërkojmë të falur, në ç'mënyrë respektojmë të tjerët etj. Me incizimin muzikor të këngës nga CD-ja, nxënësit dramatizojnë tekstin me ndihmën e mësuesit/mësueses (me lëvizjen e trupit, duke përshëndetur me dorë, me pantomimë, me mimikë etj.).

## Mollëkuqja dhe brumbulli

Mollëkuqen takoi brumbulli  
dhe e pyet: "Për ku vogëlushe?  
Ky livadhi është i imi,  
gabim ti këtu ke ardhur."

I përgjigjet mollëkuqja:  
"Çdo të thotë kjo o brumbull?  
Nuk mund të më largosh,  
Sado i fortë qofsh.

Brumbullit ton' keq i erdhi,  
Që fjal' rëndë u tregua,  
Më zë t'ulët ia ktheu:  
"O mollëkuqe, më fal mua."

Të qoft' falë ty o brumbull,  
Prap përgjigjet mollëkuqja,  
Grindja kështu përfundoi,  
mir'kuptimi veç pasoi.

Mollë, mollë, mollëkuqja  
trimëshë u tregua  
nga gënjeshtër e brumbullit  
aspak nuk u mashtrua.



# TRI LIVADHE

Këngë popullore nga Kroacia



Tri li - va - dhe, tri li - va - dhe, as - kund hi -je nuk gjen.  
Ve - tëm një - ri, ve - tëm një - ri, trën - da - fil i bu - kur.  
Nën të ci - lin, nën të ci - lin, vaj - zën ka zën' gju - mi.  
U - në e zgjoj, u - në e zgjoj dhe në sy e pu - thi.  
Ngre- u vaj - zo, ngre- u vaj-zo, di - ta ka a gu - ar.

## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të formësojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të dijë të këndojë me zë të lartë e me zë të ulët me nuanca dinamike, si edhe më shpejt dhe më ngadalë.


**Incizimi:** "Tri livadhe", Këngë popullore nga Kroacia (CD nr. 2, 8, 9)

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Interpretimi i këngës me shoqërimin instrumental nga CD<sup>ja</sup>
4. Interpretimi i këngës në duet dhe në grupe të vogla
5. Interpretimi i këngës me tempo ose shpejtësi të ndryshme (ngadalë dhe shpejt)

## **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja kërkon nga nxënësit që të përsëritin këngët popullore të mësuara në klasën e dytë.
- 2 e 3. Në vazhdim të orës së mësimi, nxënësit e mësojnë këngën me të dëgjuar, sipas ecurisë së përcaktuar metodike. Nxënësit e këndojnë këngën nga fillimi deri në fund. Kur ta ngulitin, ata mund ta këndojnë edhe me shoqërimin instrumental nga CD<sup>ja</sup>.
4. Nxënësit e interpretojnë këngën në duet dhe në grupe të vogla me mundësinë e një nuancimi më dinamik. Ata nxjerrin përfundimin se e njëjta këngë mund të këndohet me forcë të ndryshme (qetë dhe me zë të lartë).
5. Mësuesi/mësuesja e këndon këngën me tempo të ngadaltë, ndërsa nxënësit e përsëritin. Pas kësaj e këndon me tempo të shpejtë, ndërsa nxënësit përsëritin në të njëjtën mënyrë. Ata nxjerrin përfundimin se e njëjta këngë mund të këndohet me shpejtësi të ndryshme.



## KRIJIMTARIA POPULLORE

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- t'i dallojë instrumentet muzikore popullore sipas ngjyrës, timbrit të tingujve të tyre (fyelli, lahuta, lodra)

**Incizimi:** lodra, lahuta, fyelli (CD 2, nr. 11, 12, 13)

Vallja e Bokës, valle popullore nga Mali i Zi, (CD 2. nr. 10)

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Bisedë për ilustrimet në Tekstin mësimor
3. Dëgjimi i incizimeve muzikore
4. Këndimi i këngëve popullore


### **Udhëzime**

1. Nxënësit bisedojnë për krijimtarinë popullore (përsëritin atë që është mësuar për krijimtarinë popullore gjatë mëimit të lëndës *Natyra dhe shoqëria* dhe *Gjuha shqipe dhe letërsia*). Përmes mëimit të lëndës *Kultura muzikore*, sidomos përmes këngëve e vallevë popullore, ata duhet të zhvillojnë dashurinë ndaj vendlindjes.
2. Mësuesi/mësuesja i udhëzon nxënësit që ta shohin Tekstin mësimor. Nxënësit i komentojnë instrumentet (fyelli, lodra, lahuta) dhe objektet e vjetra karakteristike (veshja popullore, stolat me tri këmbë). Instrumentet: materiali prej të cilit punohen, si u bihet, në ç'muzikë përdoren ... . Mësuesi/mësuesja shpjegon se të gjitha objektet e vjetra karakteristike dhe instrumentet etj., që janë tipike për një popull, i përkasin krijimtarisë popullore.
3. Nxënësit dëgjojnë incizimet muzikore dhe dallojnë instrumentet e vallet popullore.
4. Pason këndimi i këngëve popullore të mësuara tashmë.



# ENCI MENCI

Autori i panjohur



## **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të zhvillojë idenë për ritmin
- të aftësohet që t'i dallojë instrumentet e Orfit sipas tingëllimit

## **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës së numërimit
3. Formimi i grupeve
4. Interpretimi i këngës së numërimit
5. Interpretimi i këngës së numërimit në duet

## **Udhëzime**

1. Nxënësit përsëritin këngën e numërimit "Dallëndyshja".
2. Nxënësit mësojnë këngën e numërimit sipas ecurisë së përcaktuar metodike.
3. Mësuesi/mësuesja formon tri grupe:
  - Grupi I interpreton këngën e numërimit.
  - Grupi II e shoqëron orkestrimin me "trokitësit".
  - Grupi III e shoqëron orkestrimin me tupan.

Çdo grup e interpreton veçmas pjesën e vet sipas orkestrimit të dhënë.

4. Grupet e interpretojnë së bashku këngën e numërimit sipas orkestrimit në Tekstin mësimor.
5. Pason interpretimi i këngës së numërimit. Dueti e interpreton këngën e numërimit duke ndjekur orkestrimin në Tekstin mësimor.

*Shënim: Nëse në klasë nuk ekziston numri i mjaftueshëm "i trokitësve" dhe i tambureve mësuesi/mësuesja mund të përdorë në vend të "trokitësve" e të tambureve instrumentet që ka, ose grupi II përplas shuplakat me njëra-tjetrën, ndërsa grupi III i përplas shuplakat mbi gjunjë. Nxënësit mund t'i punojnë në shtëpi instrumentet: "trokitësit", tamburet, shkopinjtë. Si udhëzim për punimin e instrumenteve të shihet Libri i mësuesit, "Mrekullia e muzikës 1", fq. 38.*



# CURULAJA

Teksti: Autor i panjohur  
Muzika: Luigj Dedvukaj



Cu - ru, cu - ru - la - ja, ne - sër na vjen da - ja,  
Da - ja vjen, gjë s'na bjen, ne i shkojm' gjë s'i çojm'.

## Curulaja

Curu, curulaja, nësër na vjen daja,  
daja vjen, gjë s'na bjen ne i shkojm', gjë si çojm'.

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të modelojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të fitojë njohuri se, përmes valleve muzikore, mësohet si të ushtrohet dhe shoqërohet zëri.

**Incizimi:** "Curulaja", teksti: autor i panjohur, muzika: L. Dedvukaj (CD-ë 2, nr. 14, 15)

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Mësimi i këngës
3. Këndimi i këngës
4. Mësimi i hapave
5. Interpretimi i këngës duke kërcyer





### Udhëzime

1. Nxënësit përsëritin këngën e numërimit "Enci menci".
2. Pason mësimi i këngës sipas ecurisë së përcaktuar metodike. Mësuesi/mësuesja merr intonacionin fillestar, ndërsa pastaj e këndon këngën nga fillimi deri në fund. Pas kësaj e këndon varg pas vargu, ndërsa nxënësit përsëritin. Bashkojnë vargun me varg dhe e mësojnë këngën deri në fund.
3. Nxënësit e interpretojnë këngën.
4. Mësuesi/mësuesja i demonstroi hapat.

Përshkrimi i këngës:

Nxënësit formojnë rrethin.

*Curu, curulaja ...* Lëvizin me këmbën e djathtë katër hapa para (e djathta, e majta, e djathta, e majta) dhe katër hapa prapa (e majta, e djathta, e majta, e djathta).

*Daja vjen ...* Një hap djathtas me këmbën e djathtë duke tërhequr të majtën dhe me këmbën e majtë majtas duke tërhequr të djathtën (dy herë).

5. Nxënësit e interpretojnë këngën duke kënduar.

*Shënim: Dihet se nxënësit e moshave të ulëta i përvetësojnë shpejt këngët në gjuhë të huaj dhe se për ata kjo gjë është shumë tërheqëse. Duke mësuar këngën në gjuhën shqipe, nxënësit që gjuhën shqipe nuk e kanë gjuhë amtare, formojnë përmes muzikës ndjesinë për respektimin e dallimeve dhe krijojnë spontanisht vetëdijen për shoqërinë multikulturore në të cilën jetojnë.*

## NE VËLLEZËRIT TERZIE

Këngë popullore nga BeH



"Ne vë - llez' - rit ter - zi - e, ter - zi - e, ter - zi - e!"

<sup>5</sup>  
"E ne mot - rat që - ndi - sim, që - ndi - sim, që - ndi - sim!"


### Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të formësojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të fitojë njohuri se ekzistojnë hapat që janë krijuar për muzikën e dhënë

### Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Shpjegimi i fjalëve të panjohura
3. Formimi i grupeve
4. Mësimi i këngës
5. Interpretimi i këngës
6. Mësimi i hapave
7. Interpretimi i këngës popullore të shoqëruar me incizimin muzikor



**Incizimi:** "Ne vëllezërit terzie", këngë popullore nga Bosnja e Hercegovina (CD 2, nr. 16, 17)

### **Udhëzime**

1. Mësuesi/mësuesja pastaj edhe nxënësit, një nga një, trokasin ritmet e ndryshme shuplakë mbi shuplakë.
2. Pason shpjegimi i fjalëve të panjohura (p.sh. terzi = rrobaqepës etj.).
3. Mësuesi/mësuesja formon dy grupe (nxënësit e nxënëset).
- 4 e 5. Nxënësit e mësojnë këngën sipas ecurisë së përcaktuar metodike dhe pastaj e interpretojnë.
6. Mësuesi/mësuesja demonstroi hapat: Formohen dy rreshta njëri përballë tjetrit (në njërin rresht janë nxënësit, ndërsa në tjetrin janë nxënëset).  
Nxënësit: *Ne vëllezërit terzie* katër hapa para (e djathta, e majta, e djathta, e majta), *terzie* dy hapa prapa (e majta, e djathta) dhe *terzie* tri hapa në vend (e majta, e djathta, e majta).  
Nxënëset: *Ne motrat që qëndisim* katër hapa para (e djathta, e majta, e djathta, e majta), *qëndisim* dy hapa prapa (e majta, e djathta) dhe *qëndisim* tri hapa në vend (e majta, e djathta, e majta).  
Në të njëjtën mënyrë kërcëhet çdo strofë.
7. Nxënësit këndojnë të shoqëruar me incizimin muzikor nga CD<sup>ja</sup>.

## GJITHË KJO ËSHTË MUZIKË

### **Qëllimi operativevi**

Nxënësi/nxënësja duhet:

- të përvetësojnë nocionin orkestër dhe dirigjent
- të dijë se muzikën (kompozimin muzikor) e krijon kompozitori
- të dallojë me të dëgjuar këndimin ose interpretimin solo ose në grup
- të ushtrohet në dëgjimin njëkohësisht të dy instrumenteve

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Përsëritja e nocioneve: kor, solist, orkestër, dirigjent
3. Mësimi i nocionit kompozitor
4. Dëgjimi i incizimeve

**Incizimi:** Xh. Rosini: Uvertura e operës "Vilhelm Teli" (CD 2, nr. 18)


solo: L. V. Bethoven: "Për Elizën" (CD 2, nr. 19)

duo: Piano e flaut, pjesë e zgjedhur (CD 2, nr. 20)

kori: *Miq e shokë* (CD 2, nr. 21)

### **Udhëzime**

1. Nxënësit bisedojnë për atë se çfarë përfaqëson për ta muzika, a mund të ndikojë ajo në gjendjen e tyre shpirtërore, në ç'mënyrë mund të ndikojë etj.
2. Mësuesi/mësuesja këndon vetëm fillimin ose refrenin sipas përzgjedhjes së vet. Herën e parë këndon shpejt, ndërsa pastaj ngadalë. Nxënësit nxjerrin përfundimin se muzika mund të interpretohet shpejt ose ngadalë. Pastaj, mësuesi/mësuesja e këndon po të njëjtën pjesë të këngës më zë të ulët (qetë) e me zë të lartë, ndërsa nxënësit nxjerrin përfundimin se muzika mund të interpretohet me zë të ulët e me zë të lartë. Pas kësaj, këngën e këndojnë të gjithë nxënësit, ndërsa më pas, mësuesi/mësuesja veçon një nxënës ose nxënëse që të këndojë solo. Nxënësit nxjerrin përfundimin se të kënduarit së bashku është kori, ndërsa një nxënës ose një nxënëse që këndon, është solisti.



3. Nxënësit përcaktojnë nocionin kompozitor/kompozitore (kompozim, të kompozuarit). Mësuesi/ mësuesja shpjegon se artistët që krijojnë muzikë janë kompozitorë. Muzika shkruhet me nota (shkruhet një notë në dërrasë të zezë), ashtu siç shkruhen fjalët me shkronja. Krijimi i muzikës quhet të kompozuarit, ndërsa vepra muzikore quhet kompozim.

4. Nxënësve u thuhet se duhet t'i dëgjojnë me vëmendje shembujt e incizimeve muzikore dhe se pas dëgjimit do ta lidhin kompozimin me ilustrimin në Tekstin mësimor (pianoja ose violina, pianoja-solo ose solistin në piano, kori ose orkestra).

## MIQËSIA

Teksti: B. Durkoviç  
Muzika: V. F. Bogiqeviç



Miq'-si-a ë-shtë per-la nga më buk-ra guackë, miq'

<sup>3</sup> -si -a është qe-shja, kur të ka - lon dhim - bja. Miq'-

<sup>4</sup> -si -a është i laç për të gji - tha s'mun - djet,

<sup>5</sup> që shpejt të ka - loj - në kur pra - në ke mi - kun. Miq'-



## Miqësia

Është një kënd i vogël, në zemër e ruaj.  
Është një vend i madh mbretëri e pafund,  
Është një kukull që mbaj pranë vetes kur fle,  
N'ëndrrat më t' bukura miqësia më shpie.

Fluturoj, fluturoj, në krahët e ënd'rrës.  
Fluturoj, ëndërroj, frikë nga askush s'kam.  
Mbylli sytë e vështroj dhe shoh un' çdo skaj.  
Qeshjen e gëzimin me shok' e shoqe ndaj.

Refreni: Miqësia është perla nga më e bukura guacë,  
Miqësia është qeshja kur të kalon dhimbja.  
Miqësia është ilaç për të gjitha sëmundjet,  
që shpejt kalojnë kur pranë ke mikun.

Këngë ne këndojmë, për të brohorasim.  
Pa miqësi kjo jet', si do të na dukej?  
Miqësi për të gjithë, miqësi kudo,  
fron i mbretërisë fëmijërore është ajo.

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të formësojë zërin e të kënduarit dhe ta zgjerojë gradualisht diapazonin e zërit
- të ushtrohet në shqiptimin e rrokjeve me rrahjen e shuplakave, me mërmëritje, me trokitje
- të fitojë njohuri se përmes muzikës mësohet si të shoqërohem

**Incizimi:** "Miqësia", teksti: B. Durkoviç, muzika: V. F. Bogiqeviç (CD<sup>e</sup> 2, nr. 22, 23)

### **Hapat kryesorë**

1. Dëgjimi i këngës
2. Mësimi i refrenit të këngës
3. Interpretimi i refrenit të këngës
4. Mësimi i strofave rep
5. Interpretimi i strofave rep
6. Interpretimi i këngës


### **Udhëzime**

1. Lëshohet incizimi muzikor i këngës rep "Miqësia", ndërsa nga nxënësit kërkohet që të shprehin përshtypjet e veta të para për këngën. Mësuesi/mësuesja bën të ditur se do të mësojnë këngën që është ndryshe nga këngët e mësuara deri tani. Nxënësit këndojnë vetëm refrenin e këngës, ndërsa strofat e tjera i mësojnë që ta shqiptojnë ritmikisht qartë tekstin.
2. Pason mësimi i refrenit të këngës "Miqësia" sipas ecurisë së përcaktuar metodike (refreni: *Miqësia është perla nga më e bukura guacë...*).
3. Interpretimi i refrenit të këngës.
- 4 e 5. Kënga ka dymbëdhjetë vargje që repohen dhe katër vargje për t'u kënduar. Ndahen dymbëdhjetë nxënës e nxënëse që kanë detyrë të mësojnë nga një varg të këngës. Mësuesi/mësuesja repon ose lëshon vargun e parë të këngës nga CD<sup>ja</sup>, pastaj nxënësit/nxënëset përsëritin dy, tri herë. Kur e mësojnë, bashkojnë vargun e parë e të dytë dhe shtojnë vargun e nxënësit ose të nxënëses së tretë. Veprohet kështu deri tek vargu i dymbëdhjetë, d.m.th. deri në fund të strofës së tretë që është për rep. Refrenin e këndojnë të gjithë nxënësit.
6. Nxënësit/nxënëset e interpretojnë së bashku gjithë këngën (tri strofat nxënësit që reponjë dhe refrenin që këndohet).

*Shënim: Nxënësve që nuk kanë pasur rastin që të reponjë u duhet mundësuar kjo gjë në një nga orët e ardhshme të mësimi.*

# VERA E GËZUESHME





## RUAJE PLANETIN

Teksti: J. M. Bogojeviq  
Muzika: M. Papiq

### **Qëllimi operativ**

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të kuptojë se të gjithë, pavarësisht nga muzikaliteti, e ndjejmë dhe e përjetojmë muzikën

**Incizimi:** "Ruaje planetin", teksti: J. M. Bogojeviq, muzika: M. Papiq (CD-ë 2, nr. 24)

### **Hapat kryesorë**

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i këngës
3. Shprehja e përjetimit muzikor

### **Udhëzime**

1. Në pjesën hyrëse të orës së mësimi, nxënësit bisedojnë për ruajtjen e mjedisit të jetesës, për mënyrën sesi ndotet natyra dhe çfarë mund të bëjmë për ta ruajtur atë.
2. Mësuesi/mësuesja lëshon incizimin muzikor të këngës.
3. Nxënësit, duke e dëgjuar këngën, përpunojnë monografinë dhe kërcejnë duke e ndjekur ritmin. Përjetimin e vet nxënësit mund ta pasqyrojnë edhe me ilustrime figurative.

*Shënim: Nëse e quan të arsyeshme, mësuesi/mësuesja mund të lidhë në një orë mësimi temat "Ruaje planetin" dhe "Përshëndetje nga Mali i Zi"*

Secila stinë e vitit ka bukuritë e veta  
Vera detin e diellin, dimri fjollat në flokë,  
Pranvera livadhin me lule, luleborën e zogjtë,  
Vjeshta frute të pjekura që në pemë rriten.

Viti ngjan kështu me mozaikun lara-lara  
dhe çdo stinë krenohet me bukuritë e veta.  
Valët e kaltra plot shkumë, degët me gjethe veshur,  
Janë pjesë ngjyrash të tokës që natyra i krijon.

Ndaj ruaje planetin ku ti rritesh e jeton,  
dhe mahnitu me bukuritë e natyrës që të rrethon,  
sepse ti je si fëmijë ajo pjesa më e bukur e tij.



# PËRSHËNDETJE NGA MALI I ZI

Teksti J. Dedeiq  
Muzika: V. F. Bogiqeviq

## Qëllimi operativ

Nxënësi/nxënësjë duhet:

- të kuptojë se të gjithë, pavarësisht nga muzikaliteti, e ndjejnë dhe e përjetojnë muzikën
- të vërejnë se kompozimet muzikore “zbulojnë” gjendje shpirtërore, ngjarje, tregime e përralla të ndryshme

**Incizimi:** “Përshëndetje nga Mali i Zi”, teksti: J. Dedeiq, muzika: V. F. Bogiqeviq (CD<sup>ë</sup> 2, nr. 26),  
*Përshëndetje nga Tajlanda*, (CD 2 nr. 25)

## Hapat kryesorë

1. Pjesa hyrëse
2. Dëgjimi i incizimit muzikor të këngës
3. Shprehja e përjetimit muzikor
4. Dëgjimi i këngës “Përshëndetje nga Tajlanda” dhe përpunimi i koreografisë


## Udhëzime

1. Në pjesën hyrëse të orës së mësimt, nxënësit bisedojnë për pushimet verore që po afrojnë, për bukuritë natyrore të Malit të Zi dhe për përjetimin e vet të atdheut. Ata mësojnë, sesi t’i ruajnë bukuritë natyrore dhe në ç’mënyrë mund të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit të jetesës.
2. Nxënësit dëgjojnë incizimin muzikor të këngës “Përshëndetje nga Mali i Zi”. Ata duhet të thonë, nëse këngën e interpreton kori ose solisti, në çfarë tempi interpretohet (ngadalë, shpejt, mesatarisht).
3. Përjetimin e vet nxënësit e shprehin duke vizatuar një temë për atdheun. Pas kësaj i komentojnë vizatimet e veta. Mund ta përpunojnë edhe koreografinë për këngën “Përshëndetje nga Mali i Zi”.
4. Nxënësit tregojnë, nëse kanë vizituar ndonjë shtet tjetër, se për ç’gjë është karakteristik ai. Pastaj dëgjojnë këngën “Përshëndetje Tajlanda” për të cilën përpunojnë edhe koreografinë.

Vendi ynë i vogël është  
por të madhe zemrën ka.  
Le të vijë kush të dojë,  
të gjithë miq ky vend i ka.

Ejani në Mal të Zi,  
zemra me gëzim t’u mbushet.  
Gjëra t’bukura do t’shikoni,  
gjëra t’bukura do t’shijoni.

Nëpër shekuj është ruajtur  
shumë krenar siç ka qenë,  
Hapi krahët e tu të ngrohtë,  
Mal i Zi, e dashur nënë.



## PËRGATITIM SHFAQJEN

Daljet publike kanë rol të rëndësishëm në procesin e pjekurisë. Krijimi i vetëbesimit, çlirimi nga frika, shfaqja e lirë e përjetimit vetjak, dëshira për ta ndarë përjetimin me të tjerët, këndimi së bashku në kor, përqendrimi dhe zhvillimi i kujtesës, janë vetëm disa nga përparësitë e daljes publike.

Me qëllim që t'i nxitim mësuesit/mësueset për të organizuar shfaqjet muzikore, ne kemi ofruar disa përmbajtje që i përgjigjen kësaj veprimtarie. Në organizimin e shfaqjes duhet të marrin pjesë të gjithë nxënësit, të shfaqin lirshëm afinitetet e veta (disa do të shprehin dëshirën që të dalin si solistë, ta përpunojnë koreografinë, të interpretojnë në "orkestrën" e përbërë nga instrumentet e Orfit ose të këndojnë në kor). Në varësi të motivimit, në shfaqje mund të interpretohen këngët më poshtë:

*"Dimri"* dhe *"Mbrëmja magjike"* i përgjigjen shfaqjes së Vitit të Ri,

*"Nëna"*, Ditës së grave,

*"Ruaje planetin"*, *"Përshëndetje nga Mali i Zi"*, *"Miqësia"* janë këngë ritmike dhe, për këtë arsye, janë të përshtatshme për koreografi.

*"Pinoku"* dhe *"Ëndrra"* mund të dramatizohen.

Këngët popullore mund të interpretohen të shoqëruara me një koreografi të thjeshtë të valleve popullore.

Incizimet e propozuara për t'u dëgjuar, në varësi të karakterit të tyre, mund të shfrytëzohen si muzikë për koreografinë ose për dramatizimin.

Në shfaqje duhet të marrin pjesë të gjithë nxënësit. Udhëzimet që janë dhënë në përgatitjet për zhvillimin e temave të mësimit, mund të vihen në zbatim si përgatitje për daljet publike në varësi të përmbajtjes së vetë shfaqjes. Përgatitja dhe interpretimi i shfaqjes është një mënyrë e mirë, që të ripërtërihen e të përsosën disa segmente të lëndës së mësuar.

Pas shfaqjes, nxënësit shprehin në orën pasardhëse (verbalisht, figurativisht) përshtypjet e veta.

Nxënësit duhet të stimulohen që, përmes shfaqjes, ta manifestojnë frymën e vet krijuese, por edhe ta zotërojnë punën në ekip.





## Literatura

1. J. R. Bjerkvol: *"Nadahnuto biće-dete i pesma, igra i učenje kroz životna doba"*, (*"Qenie e frymëzuar – fëmija dhe kënga, kërcimi dhe mësimi gjatë moshave të jetës"*), Plato, Beograd, v. 2005.
2. Miodrag Vasiljeviq: (*"Narodne melodije Crne Gore"*), (*"Meloditë popullore të Malit të Zi"*), Instituti i Muzikologjisë, Beograd, v. 1965.
3. Branka Vujiçiq, Ivana Dediq, Aleksandra Naumovski: (*"Čudesni svijet zvukova 1"*), (*"Bota magjepsëse e tingujve 1"*), Kultura muzikore për klasën e parë të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, v. 2005.
4. Branka Vujiçiq, Sunçica Kostiq, Snezhana Gjurishiq, Aleksandra Naumovski: (*"Čudesni svijet zvukova 2"*), (*"Bota magjepsëse e tingujve 2"*), Kultura muzikore për klasën e dytë të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, v. 2005.
5. Liljana Goran, Lerka Mariq: *"Zapjevajmo složno svi"*, (*"Të këndojmë harmonikisht të gjithë"*), Libri shkollor, Zagreb, v. 1987.
6. Nikolla Gregoviq, Anton Homen: (*"Pjevajmo svi"*), (*"Të këndojmë të gjithë"*), SIZ<sup>i</sup> i Kulturës, SIZ<sup>i</sup> i Shkollimit, Kotor dhe OI Nota Knjazhevac, v. 1982.
7. Mirjana Ivanoviq: (*"Metodika nastave muzičkog vaspitanja u osnovnoj školi"*), (*"Metodika e mësimin të Edukimit muzikor në shkollën fillore"*), Nota, Knjazhevac, v. 1981.
8. Nada Ivanoviq: (*"Muzika u osnovnoj školi"*), (*"Muzika në shkollën fillore"*), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, v. 2008.
9. Vlladica Iliq: (*"Muzička kultura za prvi razred osnovne škol "*), (*"Kultura muzikore për klasën e parë të shkollës fillore"*), Kreativni centar, Beograd, v. 2008.
10. Vlladica Iliq: (*"Muzička kultura za treći razred osnovne škole"*), (*"Kultura muzikore për klasën e tretë të shkollës fillore "*), Kreativni centar, Beograd, v. 2008.
11. Nada Jabllanov: (*"Narodne pjesme i igre za djecu, roditelje, vaspitače i učitelje"*), (*"Këngët popullore për fëmijët, prindërit, edukatorët dhe mësuesit"*), Kreativni centar, Beograd, v. 2006.
12. Nada Jabllanov: (*"Zaigrajmo veselo; narodnje igre s pevanjem"*), (*"Të hedhim valle të gëzuar; këngë popullore të kënduara"*), Kreativni centar, Beograd, v. 2009.
13. Vishnja Manasterioti: (*"Zbornik"*), (*"Almanaku"*), Libri shkollor, Zagreb, v. 1988.
14. Albinca Pesek: (*"Glasba 1- Zapoimo, zaigrajmo in zaplešimo, delovi udžbenika za glasbo b prvem razredu osnovne škole"*), (*"Muzika 1 - Të këndojmë, të kërcëjmë e të hedhim valle, pjesë të tekstit të muzikës për klasën e parë të shkollës fillore"*), Mlladinska knjiga. Lubljanë, v. 2008
15. Nevenka Petriçeviq, Olivera Nikoliq: (*"Čudesni svijet zvukova 3"*), (*"Bota magjepsëse e tingujve 3"*), Kultura muzikore për klasën e tretë të shkollës fillore, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, v. 2007.
16. Jozhe Pozhgai: (*"Metodika glazbenog odgoja u osnovnoj školi"*), (*"Metodika e Edukimit muzikor në shkollën fillore"*), Asambleja e Arsimit e Kroacisë, Zagreb, v. 1975.
17. Petar Stokoviq: (*"Nastava muzičke kulture"*), (*"Mësimi i Kulturës muzikore "*), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, v. 1988.
18. Sinichi Suzuki: *"Methods for music education"*, Suzuki Music Academy, New York, v. 1988.
19. Sinichi Suzuki: *"Nurtured by Love, The Classic Approach of Talent Education"*, Suzuki Method International Summu – Birchard INC., Miami, v. 1983.
20. Elaine Streeter: *"Making music with the young child with sepecial needs"*, Jessica Kingsley Publissier, London and Philadelphia, v. 2001.
21. Zafir Haxhimanov: (*"Raspevane pesme"*), (*"Këngë të hareshme"*), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, v. 2010.
22. Suzanne B. Hanser: *"The new music therapist handbook"*, Berklee press, Boston, v. 1999
23. Nadezhda Hiba: (*"Muzika za najmlađe"*), (*"Muzika për më të rinjtë"*), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, v. 1986.
24. Programi i lëndës për ciklin e parë të shkollës fillore (versioni i përmirësuar), Enti i Shkollimit; Podgoricë, v. 2009.



SHËNIME

A series of 25 horizontal dotted lines for writing notes.

